

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI JURIDIK

Kandidatja: Miradie Svarça

Mentori: Prof.Dr.Bedri Peci

Tema: “ Modelet e kontrollit të jashtëm buxhetor në teorinë dhe praktikën buxhetore”

Abstrakti

Ky punim i diplomës së Masterit, paraqet një koncept të asaj se ku qëndron roli kryesor i kontrollit buxhetor, i cili është një nga elementet më të komplikuar dhe më aktuale në të drejtën buxhetore. Në botën bashkëkohore, shtetet mundohen që përmes kontrollit buxhetor të krijojnë një stabilitet social dhe zhvillim ekonomik, në mënyrë që efikasiteti dhe efektiviteti të ndikojnë rrënjësisht për një buxhet zhvillimor.

Synimi i këtij punimi është që të trajtojmë temën në lidhje me mënyrën e funksionimit të kontrollit buxhetor, se si mund të planifikohet shpenzimi adekuat i mjeteve buxhetore.

Gjatë shtjellimit të punimit, do të flitet për Institucionet Supreme të Auditimit ku do të ceken funksionet kryesore dhe bashkëpunimi i tyre me organet e tjera të auditimit publik në nivel kombëtar, me ç’rast kemi arritur të kuptojmë se ushtrimi i kontrollit nëpërmjet këtyre institucioneve, ka një ndikim pozitiv dhe rol kyç në krijimin e mekanizmave të mbikëqyrjes së buxhetit, ku nëpërmjet raporteve dhe gjetjeve të tyre krijohet efikasitet dhe efikasitet në përdorimin e fondeve publike.

Me theks të veçantë do të paraqiten dy modelet e kontrollit të jashtëm buxhetor siç janë: Modeli i Gjykatës së Auditorëve (modeli gjermano -romak) dhe Zyra e Auditorëve (modeli anglo - sakson), ku do të elaborohet krijimi dhe roli i këtyre dy modeleve.

Si përfundim të këtij punimi, kemi arritur të kuptojmë se duke qenë të fokusuar në mbikëqyrjen dhe llogaridhënien e shpenzimeve publike, atëherë rezulton se këto dy modele të kontrollit të jashtëm buxhetor sigurojnë që të ketë transparencë, si dhe duke kërkuar llogari nga qeveria ndihmojnë në përmirësimin e shërbimeve publike nëpërmjet auditimeve me cilësi të larta.

Fjalët kyçe: Kontrolli i buxhetit, Institucionet Supreme të Auditimit, Modelet e Kontrollit të jashtëm buxhetor.